



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 17 Prot.

Tiranë, më datë 10.01.2025

VENDIM
Nr. 16, datë 10.01.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 10.01.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor hartuar në kuadër të projektit “Kompleks agroturizëm, bletari dhe shërbim me 1, 2 dhe 4 kat, parkim nëntokë dhe mur rrethues”, ndodhur në Dukat-Fshat, Vlorë, Njësia Strukturore OR.B.45, me zhvillues subjekti “Ameti” sh.p.k.;
 2. Investitori duhet të lidhë akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin “Kompleks agroturizëm, bletari dhe shërbim me 1, 2 dhe 4 kat, parkim nëntokë dhe mur rrethues”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

KRYETAR
Blendi GONXHJA